



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/03-27379 dt. 22.06.2021

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Labinot Halilaj, më datë: 29. 06. 2021 (e Marte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 31.05.2021
2. Propozim Vendim i pikës 17, të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.
3. Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024.
4. Propozim Vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit i plotësuar.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26. 02. 2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.
6. Njoftim lidhur me shkresën për koston e Kontratave Kolektive.
7. Të ndryshme.

Drenas, 22.06.2021





REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/03-27379 dt. 22.06. 2021

Rekomandimet e dhëna nga Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur me datë: 18.06.2021, si vijon:

-Pasi kryesuesi përshëndeti të pranishmit njoftoi anëtarët e K.P.F-ca për rendin e ditës.
Nënkryetari i Komunës Arben Shala propozoj edhe tri pika shtesë: 1. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zvdrejtor në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, i plotësuar.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26.02.2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar. 3. Njoftim- shkresë lidhur me koston e Kontratave Kolektive.
Kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me këto tri pika shtesë ku të gjithë anëtarët e K.P.F-së u pajtuan me këtë rend dite, dhe e votuan në mënyrë anonime:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 24.05.2021. Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime.

2. Propozim Vendim i pikës 17, të nenit 1, të Vendimit nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, edhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend.

3. Draft -Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024. Pas sqarimit të kësaj pike nga drejtori i financave Shyqyri Bublaku, nuk pati diskutime tjera dhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë anonime.

4. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zvdrejtor në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, i plotësuar.

Pas sqarimit të kësaj pike nga drejtori i arsimit Muhamet Gjoka, nuk pati diskutime tjera dhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë anonime.

5. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2, të Vendimit nr. 12-360/02-9351, të dt. 26.02.2021 të Kuvendit Komunal të Drenasit, i plotësuar.

Pas sqarimit të kësaj pike nga drejtori i shëndetësisë Arsim Haxhiu, nuk pati diskutime tjera dhe kjo pikë e rendit të ditës u rekomandua për kuvend në mënyrë anonime.

6. Njoftim- shkresë lidhur me koston e Kontratave Kolektive. Sqarim nga Drejtori i Financave Shyqyri Bublaku.

7. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime.

Drenas, 18.06.2021



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Halil Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/04-25627 dt. 11.06 . 2021

**Mbledhja e rregullt
Kuvendi Komunal
31.05.2021**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 31.05.2021

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 28 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i dt. 28.04.2021
2. Raporti i përditësuar epidemiologjik i Komunës së Drenasit lidhur me pandeminë me Covid-19 (vir.SARS-COV2) Mars-Maj 2020-2021 si dhe procesi i deritanishëm i imunizimit–(vaksinimit)
3. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikës.
4. Propozim-Diskutim i Raportit të punëve të Kompanive KRM (Pastrimi) dhe KRU- (Prishtina) në Drenas.
5. Të ndryshme.



Në mbledhje moren pjesë: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, kryetari i komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, drejtor të drejtorive komunale, shefi i kabinetit Fla,mur Curri si dhe 28 anetar të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoj se për diskutim janë 5 pika për rend dite mirëpo kryetari i komunës **Ramiz Lladrovci** ka propozuar edhe tri pika të tjera shtese për këtë rend ditë.

1. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Insutucionet Edukatio-Arsimore në Komunën e e Drenasit.

2. Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2 të vendimit Nr. 12-360/02-9351i datës 26.02.2021 dhe

3. Propozim vendim për lirim nga pagesa e peronizmit për kompanitë e transportit publik të udhëtareve me autobus për linjat urbano-peiferike dhe nder urbane që e shfrytëzojnë Stacionin e Autobusëve për operim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, hodhi në votim rendin e ditës me këto tri pika shtesë që i propozoi kryetari, prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 28 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas e dt. 28.04.2021.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë te rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar:

Për votuan 28 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2.Raporti i përditësuar epidemiologjik i Komunës së Drenasit lidhur me pandeminë me Covid-19 (vir.SARS-COV2) Mars-Maj 2020-2021 si dhe procesi i deritanishëm i imunizimit–(vaksinimit)

Drejtori i shëndetësisë Arsim Haxhiu, sqaroi që ka një raport përmbledhës i përditësuar epidemiologjik me sars-cov2 Drenas për vitin 2020/2021 dhe procesi i deritanishëm vaksinimit. Gjithsej raste nga epidemiologjia me test pozitiv Sars-cov2 sipas grup moshave për vitin 2020/2021 gjithsej janë 1872, ndërsa raste te shënuara 1784, ndërsa vdekshmëria deri me tani ka gene 69. Numri i te vaksinuarve me vaksinën Astra Zeneca dhe Pfizer me dt 17.05.2021 totali është 1167, Astra Zeneca 1095, Pfizer 72, mbi moshën 65 vjeç 1090, punëtorët shendetesor74, pacientë te hemodializes 3, ky është një raport i përditësuar.

Sabrije Kukaj, sa i përket këtyre me insulinë, një tryezë e cila u mbajt në diamant ka pas pa kënaqësi të mëdha nga ata që janë me insuline, pse nuk po ndahet drejt insulina, kërkoj që kur te vjen insulina të ndahet në mënyrë proporcionale.

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, secili shfrytëzues i insulinës që është me diabet, çdo pacient i ka kartelat e veta dozat nuk jepen në mënyrë proporcionale të shpërndara sepse secili anëtar ka dozat e veta varësisht prej gjendjes se diabetit.

Sokol Bylykbashi, kam informacione nga QKMF-ja se janë dy aparatura për analiza që janë jashtë funksionit se paku që dy muaj kanë qenë, nuk e di arsyeën pse deri me tani nuk kanë punuar, është pa përgjithësi me e lenë jashtë funksionit këto aparatura shumë të nevojshme të cilat ndërlidhen me situatën e pandemisë që jemi sepse doktorët e dinë se mjeket na sugjerojnë me bo analiza dhe dihet që këto analiza në laborator privat e kanë atë koston e vet, a janë duke punuar ato aparatura apo janë jashtë funksionit dhe çka ka qenë problemi?

Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu, çështja e biokimisë kryhet mirëpo nuk kryhet vetëm me një aparaturë, problematiken që e kemi për momentin në zgjidhje e sipër është çështja e servilizmit të tyre, për shkak se ato kur skadojnë në një numër të tejkuluar, aparaturat kanë një sistem mbrojtës të cilat kur kalojnë numrin optimal të kalibruar të tyre atëherë stopojnë, ne jemi në procedurë të rregullimit të kontratës të servisimit për arsyeje se nuk ka një standardizim në Kosovë të aparaturave ku do të mund të rregullohen të gjitha, por ka prodhime të ndryshme dhe është në procedurë të rregullimit të kësaj çështje.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, meqë ky raport nuk votohet kalojmë të pika tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:
3.Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit për monitorimin e Kodit të Etikës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, komuna e propozon nga ekzekutivi Haki Bekolli, nga qytetar me integritet të dëshmuar Ariana Isufi dhe Vlora Zariqi.

Gani Podrimqaku, nga grupi PDK-së e propozojmë Antigona Istogu

Sabrije Kukaj, prej opozitës e caktojmë Edolina Plakiqin.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, me këta anëtar për komisionin për monitorimin e Kodit të Etikës: Haki Bekolli, Ariana Isufi dhe Vlora Zariqi ndërsa nga kuvendi Antigona Istogu dhe Edolina Plakiqi, prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar: për votuan 25 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katert të rendit të ditës:

4.Propozim-Diskutim i Raportit të punëve të Kompanive KRM (Pastrimi) dhe KRU-(Prishtina) në Drenas.

Drejtoreshë për Shërbime Publike dhe Emergjencë Lumnije Krapi, Duke bazuar në ligjin nr.Nr.087 për Ndërmarrjet Publike që kompanitë e lartshënuara janë të obliguara që të raportojnë kryetarin e komunës, bazuar në nenin 18 ligji 04/L-111 i dt.30.05.2012 ndryshimi dhe plotësimit të ligjit 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, Neni 31.6.Ligji bazik dhe neni 18 i ligjit 04/L-111 i dt. 30.05.2012 i cili thotë se Raportet Vjetore dhe Tremujore në formë të informatës i dërgohen edhe Kryetarit të Komunës në të cilën ushtron veprimtarinë e Ndërmarrja Publike në pajtim me ligjin mbi vetëqeverisjen Lokale. Pas analizës se raporteve janë vrenjtur probleme dhe sfida me të cilat janë ballafaquar kompanitë gjatë vitit 2020, të cilat probleme kanë ndikojnë

drejtpërdrejt në jetën dhe mirëqenën e qytetareve. Rrjeti i kanalizimit në zonën urbane të qytetit në Drenas është i ndërtuar në vitet 70 (shtatëdhjeta) i dimensionuar për një periudhë të caktuar kohore e që tani me rritjen e numrit të banorëve në zonën urbane po paraqiten probleme të vazhdueshme me bllokime të shpeshta. Problemet kryesorë me këto rrjeta janë: Kapaciteti jo mjaftueshëm i gypave për qarkullimin normal të ujerave të zeza, kyqjet jo profesionale të disa konsumatorëve në rrjeta e ndërtuara, mungesa e rrjetave të kanalizimeve për ujëra atmosferike kombinimi i rrjetave të kanalizimit të ujerave të zeza me ujërat atmosferike, rrjeti shumë i vjetruar i gypave të kanalizimit të ujerave të zeza dhe vështirësitë në mirëmbajtje, mungesa e kapakëve të pusëve të rrjetit si ato të ujerave të zeza ashtu edhe atmosferike, pakujdesia edhe e konsumatorëve në shfrytëzimin e rrjetave të kanalizimeve. Gjatë shqyrtimit të problemit kemi arritur në përfundim, që për mënyrën e problemit të zbatohet legjislacioni në fuqi nga organet kompetente **Përfundime:** Ndërrimi i gypave të kanalizimit të cilët nuk i plotësojnë kushtet për rrjedhje normale të ujerave të zeza

Ndërtimi i rrjetave të kanalizimeve atmosferike në zonat ku nuk ka rrjeta,

Ndarja e ujërave të zeza nga ato atmosferike

Sigurimi i paisjeve adekuate për mirëmbajtje të rrjetave.

Mirëmbajtja permanente e rrjetave

Rritja e kapaciteteve për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, kompania e ujësjellësit në nivel posedon vetëm një paisje për mirëmbajtjen e kanalizimit.

Ndërsa sa i përket zonave rurale shkaqet e bllokimeve të kanalizimeve, gjatë verifikimit të gjendjes në terren .

Hudhja e mbeturinave nga qytetarët e përgjegjës në pusët e kanalizimit.

Marrja e kapakëve të pusëve të kanalizimeve.

Derdhja e ujërave atmosferike në kanalizimin fekal sidomos nëpër kanalizimet që janë për gjatë tokave bujqësore si dhe në shumë raste edhe lidhje e ujërave të shtallave të kanalizimeve.

Punimet e rrugëve në shumicën e rasteve demtohen gypat e kanalizimeve.

Si dhe në disa fshatra seksioni i gypit të kanalizimeve nuk korrespondon me numrin e ekonomive të kyqyra në këtë kushtet atmosferike si shiu dhe vërshimet.

Ndërsa sa i përket shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, pas shqyrtimit dhe analizimit të raportit të arritur nga kompania është hartuar një rezimë si në vijim;

Bazuar në marrëveshjen për shërbimet primare të menaxhimit të mbeturinave midis komunës së Drenasit dhe KRM "Pastrimi" - Prishtinës, datë 27.01.2020, mbështetur në këtë kompani ndër të tjera angazhohet në grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale deri në vendin e caktuar.

Si informacion fillestar bazuar në raportet vjetore të kompanisë (viti 2020) numri i ekonomive familjare që pranojnë shërbim në ekonomitë familjare është 80%, biznese 35% dhe institucione 92%. Vlera totale vjetore (viti 2020) e faturimit për të gjitha kategoritë (amvisëri, biznese, institucione dhe të veçante) është 487,316.97 euro, ndërsa inkasimi vjetor për të gjitha këto kategori është 481,065.21 euro. Sasia totale vjetore e grumbullimit të mbeturinave nga KRM Pastrimi për vitin 2020 është 7,466.71 ton.

Drejtorati i DSHPE përgjatë vitit 2020 në vazhdimësi ka informuar përmes veb faqes së komunës, kompania Pastrimi në fillim të këtij viti është ballafaquar me defekte në makineri, që ka rezultuar në moskryerjen e rregulltë në disa raste të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Drenasit. Si rezultat i kësaj, janë mbajtur takime pune të vazhdueshme. Gjatë takimeve ndër të tjera temë diskutuese ka qenë ecuria e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunën e Drenasit. Gjatë takimeve përfaqësuesit e kompanisë janë informuar

mbi ankesat e qytetarëve për grumbullimin e mbeturinave, ku këto ankesa ndërlidhen edhe me raportet e dërguara nga kjo kompani se në ditë të caktuara në disa zona nuk ju kryhet shërbimi sipas orarit të caktuar. Nga kompania tregojnë se e gjithë kjo po ndodhë si rezultat i defekteve në makinerin, përkatësisht kamionat për bartjen e mbeturinave (problematika e makinerisë së vjetërsuar dhe dëmtimi i shpeshtë i pjesëve). Si përfundim në këtë pikë diskutuese ne si drejtori kemi kërkuar që kompania të rritë kapacitetet e makinerisë funksionale për grumbullimin e mbeturinave në mënyrë që qytetarëve të ju ofrohet shërbimi i rregullt i mbeturinave dhe respektimi i marrëveshjes së lidhur midis komunës dhe KRM – Pastrimi për kryerjen e shërbimit primar të mbeturinave komunale. Pas këtij takimi të realizuar deri më tani kompania në fjalë, bazuar në emailat e dërguar nga zyrtari i tyre, ende vazhdon të përballet me defekte në makineri dhe mos zbatim të itinerarit të plotë për grumbullimin e mbeturinave.

Si komunë çdo kemi vazhduar bashkëpunim me KRM duke mbështetur përmes granteve të performancës. Nga granti i performancës mjedisi i pastër i vitit 2017 si aset për kompaninë, një kamion terreni për grumbullimin e mbeturinave

Po ashtu edhe për grantet e fituara gjatë viteve 2018 dhe 2019, ku vlera e këtyre grandeve të ndara nga Gizi do të investohet në ngritje të kapaciteteve për kompaninë që operon në grumbullimin e mbeturinave. Në kuadër të kësaj është bërë vlerësimi i nevojave për mjete, dy kamion terreni për grumbullim të mbeturinave. Deri më tani bazuar në informacionet nga gizi gjerman procedurat për sigurimin e pajisjeve në kuadër të këtyre grandeve janë në fazat e prokurimit dhe brenda këtij viti do të finalizohen. Pas skadimit të afatit të “Planit të menaxhimit të mbeturinave” është formuar grupi punues në koordinim me GIZ, do të fillojnë me harrimin, plotësim dhe ndryshim të Planit për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021/25 dhe do të inkorporohen objektivat për themelimin e një Ndërmarrje publike për menaxhim të mbeturinave në kuadër të komunës.

Sokol Bykykbashi, unë e kam një vërejtje mënyra se si funksionojnë këto dy kompani të zëmë kompania për grumbullimin e mbeturinave e dimë të gjithë që kanë probleme me makineri dhe me erdhi mirë që e pash në raport që ishit në proces për blerjen e dy kamionëve besoj që kjo kish me e rregullua këtë problem, unë nuk kam shikuar njoftime nga ju si kompani as nga komuna kur nuk janë kryer shërbimet, e kam shikuar një apo dy herë por jo gjithmonë dhe nuk kanë treguar as pse nuk e kanë kryer atë shërbim dhe as kur do te kryhet, ka ndodhë qytetarëve ju kanë mbetur mbeturinat ashtu për një javë, ndërsa sa i përket kompanisë se ujësjellësit rajonal “Prishtina” edhe këta nuk e praktikojnë me bërë njoftime, unë nuk i kam shikuar në facebook, është mirë që edhe këta me na njoftu kur ka reduktime të ujit, në javën e fundit kemi mungesë të theksuar të ujit deri në gjashtë apo shtatë orë, do të ishte mirë me na njoftu me kohë dhe është mirë me tregu edhe këta se cila është arsyeja sa do te zgjasin këto reduktime?

Drejtoresha e Drejtorisë për Shërbim Publike Lumnije Krapi, i nderuar sa herë që kompania ka pas defekt në makineri neve na kanë njoftua dhe ne e kemi publikuar në web faqe të Komunës, ndërsa sa i përket kompanisë ujësjellësit ende nuk ka njoftime që ka reduktime për momentin, po kur ka reduktime atëherë ne e publikojmë ne web faqe të komunës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, sa i përket ujësjellësit, unë kam ankesa për ditë, unë jam duke e shikuar mundësinë si me vepruar me drejtorin e Ujësjellësit, sepse nuk i kryen shërbimet si duhet ata nuk i kanë përcjellë as projektet e komunës edhe pse e kanë për obligim për me i

përcjellë, ne sot kemi probleme që 2-3 vjet që nuk kanë qenë gypat hiq të vendosur nëpër tokë ata është dashur me na njoftuar neve si komunë.

Vehbi Berisha, me fol për këto dy kompani nuk mundesh me fol pa e shikuar ligjin që unë personalisht mendoj që ka një pa qartësi dhe nuk është duke shkuar mirë, pikërisht se kemi një përzierje kompetencash drejtoresha na raporton për ta sot këtu unë mendoj që ata është dashur me ardh me raportuarar këtu për të gjitha ato keq menaxhime që janë duke i bërë, personalisht po me vjen mirë që kryetari e ndanë të njëjtin mendim si unë për kompaninë e ujës-jellësit që drejtori është shumë i papërgjegjshëm, jam angazhuar me qindra raste që është pusët midis të fshatit Qikatovë në lagjen Morina është e vetmja pusët ku mundet me u ndal uji aty dhe dikush për shkak të shtypjes së ujit me qindra herë shkon e ndal kam shkuar e kam raportuar rastin asnjë mase asnjë veprim nuk është i ndenje ai njeri me marr zotëri Ismet Balija që po e përmendi me emër sepse jam shumë i pakënaqur me punën e tij një njeri që për mendimin tim as 10% të pagës se tij nuk e meriton, ka ndodhë që tri ditë unë dhe lagja ime kemi mbet pa ujë për shkak se dikush e ka pëlcit një gyp, dhe ky zotëria nuk ka qenë i aftë me siguruar një ekskavator për me rregulluar, përderisa unë të paguaj faturën ti duhet me ofruar shërbimin edhe pikë, unë mendoj që ne si komunë duhet me e gjet një zgjidhjeje se kështu nuk shkon, si vjet sa herë kemi pas të reshura të shiut katër ditë është dashur me prit derisa është kthjellur uji, hiq me mirë nuk është gjendja as me kompaninë "Pastrimi" ne po i paguajmë faturat rregullisht ata dalin thonë jo nuk mundemi në sezonin e dimrit kurrë nuk vjen në fshatra të thella ne fshatin tim një muaj Dimër kurrë nuk vjen se nuk mundem unë me ja vendose zingjiret kamionit, po nuk me intereson mu a mundesh ti a nuk mundesh për derisa unë të paguaj për me i mbledh mbeturinat ti e ke caktuar tarifën nëse duhet me shumë shpenzime dimrit atëherë bëjë tarifën dhjet euro Dimrit vetëm le ti bëjnë shërbimin si duhet ,personalisht jam lodhur nga këta njerëz që nuk janë ne gjendje ti bëjnë punët e tyre ashtu si duhet ,me qindra here i kam thirrur ne telefon i kam shkruar imell edhe bordit drejtues po as që merren me këto punë, edhe një pyetje për kompaninë pastrimi çka është duke marr masa për disa qytetar të cilët shkojnë i thonë ,unë nuk jam i kënaqur me shërbimet e juaja dhe dua me u shkyç e sjell shportën ata mbeturina kanë me bërë ku i hedhin mbeturinat ata faleminderit .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, asnjë qytetar nuk ka drejtë me shkuar me u shkyç përderisa jeton aty të kemi të qartë se inspektorati duhet me inspektua dhe me marr masa për çdo njërin, nuk guxon as kompania me e bërë atë veprim, ata të cilët nuk janë të lidhur në asfalt nuk janë edhe të lidhur me menaxhim deshta me ju propozua juve si Kuvend keni të drejt me i fillua procedurat me i pavarësua këto dy kompani përkrahjen time do të keni.

Sabrije Kukaj, deshta të di për këto shportat për riciklim të mbeturinave kam parë edhe kontejner tjerë për mbeturina organike që asnjëherë nuk janë shkuar me i marr a nuk ka kamionë a çka është problemi që këto t riciklimit të mbesin me muaj që nuk i marrin po edhe këto të mbeturinave organike janë me muaj që si kanë marr, tjetra inspektorët të këto dyqanet a kanë shporta se cili dyqan sepse po e ndotin ambientin duke i djegur mbeturinat .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ndotja e ajrit po bëhet nga shumë drejtime siç është Feronikeli pastaj nga makinat, gurëthyesit por asnjë kompetencë nuk i përket komunës sepse kontrollin e ndotjes se përditshme e bën ministria .

Petrit Sinani, sa i përket këtyre dy ndërmarrjeve të gjithë u pajtuam që gjendja në menaxhim për fajin e kujt do qoftë është shumë e dobët, sa i përket kompanisë pastrari mendoi që duhet me i ndarë gjërat se menaxhimet dhe punonjësit në Drenas janë për çdo lëvdatë duke e parë sheshin se punonjësit po punojnë, ndërsa sa i përket makinerisë kjo është për çdo vërejtje, unë me kolegun tim Bujarin jemi në bord të kompanisë por kjo kompani nuk ka bërë asgjë sa i përket investimit ne pajisje, edhe në vitin e parë si asamblist kam kërkuar që kjo kompani me kalua ne pronësi të komunës sepse ekziston ligji edhe aktet por vetëm se duhet me i ndjek procedurat ,ne jemi e vetmja Komunë në regjionin e Prishtinës e cila është rentabile sepse qytetaret e Drenasit janë shume të përgjegjshëm sa i përket kryerje se pagesave d.m.th. mundemi me arrit me i mbuluar edhe nevojat e punëtorëve mos me ju vonuar pagat ,sepse nuk ju paguhen orët pas ndërrimit , nuk ju paguhen pushimet d.m.th se pari punëtorëve kësaj kompanie nuk trajtohen si duhet e lerë me qytetaret ,sa i përket kompanisë ujësjellësi nëse nuk gabo këta kanë pasur një kontratë të mirë me Feronikelin ku i kanë ofruar shërbime dhe i kanë marr 10 deri 15.000 € për muaj në lidhje me ujësjellës sakte nuk e di ndërsa sot nuk e marrin asnjë cent prej Feronikeli. Si u tha edhe me herët Komuna në këto dy kompani si ne makineri e gjera tjera por nuk e merr shërbimin e duhur andaj po i propozoi këtij kuvendi qysh kam propozuar edhe para tri viteve të fillojmë me procedurat e kthimit të këtyre dy kompanive në menaxhimin e komunës dhe kjo besoi qe do të ishte shumë më mirë edhe për qytetaret po edhe për neve si komunë.

Drejtoresha e Drejtorisë për Shërbim Publike Lumnije Krapit, kjo është një analize jo prezantim raporti.

Sabrije Kukaj, ndoshta kjo nuk lidhet me drejtorinë tende, por ti e dinë kur ka pasur vërshime derisa ka ardh kamioni i zjarrfikëseve me larguar një pjesë të materialit ndërtimor mbeturina që kanë qenë aty d.m.th uji nuk ka lëvizur dhe kemi pasur dëme të mëdha, përsëri po ndodh e njëjta objektet që po rrënohen të shtrati i lumit aty afër është duke u bërë si kala nuk e di kush duhet të dal të shikoj dhe ti kontrolloj

Drejtoresha e Drejtorisë për Shërbim Publike Lumnije Krapit, ne për çdo vit e kemi projektin për eliminimin e mbeturinave ne web faqe të komunës e paraqesim se mbeturinat inerte duhet të dërgohen atje ku është vendi të Kisha por qytetaret nuk i dërgojnë po qytetaret po i dërgojnë aty ku po ju vjen me lehtë siç është edhe rasti që e përmendet ju.

Adem Bucolli, drejtoresh faleminderit për transparencën sa i përket anës se juaj si komunës edhe për punëtorët se punëtorët po e kryejnë punën perfektë ,e kam një propozim pasi që ne mbledhjen e kaluar ne i kemi liruar prej taksës komunale lokalet të cilat operojnë n territor të Komunës e sidomos këto që janë në dalje ne shesh me i detyruar që se cili para lokalit të vet të mirëmbajë si ne largimin e mbeturinave po ashtu edhe në korrjen e barit.

Drejtoresha e Drejtorisë për Shërbim Publike Lumnije Krapit, nuk është ne domenin e drejtorisë tonë mirëpo me sa di unë çdo biznes që ka kontrata e ka të aneks kontrata që është i obliguar me e mirëmbajt hapësirën para lokalit.

Petrit Gashi, mua me pëlqej shume dhe e përkrahi iniciativën për me e kthye kompaninë ''Pastrimi'' në kompani komunale por procedurat nëse vazhdojnë a duhet me i filluar prej tani në mënyrë që me i përfshirë ne projekt buxhetin për vitin e ardhshëm që miratohet në shtator se

me siguri duhet rritje buxheti për vitin e parë për me u pajise me makineri e gjerat tjera të nevojshme që i duhen kompanisë për me operua.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, le të merret ekzekutivi le të planifikojnë atë pjesë bashke me neve, dhe në seancat e radhës i shikojmë hapat cilët duhet të ndërmerren se pa buxhet shtesë nuk ka mundësi se ajo ka implikime buxhetore.

Drejtoresha e Drejtorisë për Shërbim Publike Lumnije Krapi – vetëm po e theksoi që në fund të raportit është e cekur që është formuar grupi punues ku njëra prej objektivave është edhe themelimi i ndërmarrjes publike te mbeturinave në kuadër te Komunës behtë planifikimi hartohet drafti shkon ne Kuvend dhe vazhdon me procedurat e tjera .

Labinot Halilaj Kryesuesi i Kuvendit Komunal, hapi diskutimin për pikën e 5 të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për caktimin e anëtareve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendësdrejtor në Insutucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.**

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka, ju vetëm jeni ne dijeni që ky propozim vendim ka kaluar në seancën e fundit vetëm se ne konsultim me zyrën ligjore të Ministrisë së Arsimit ka qenë një opinion që të ceket edhe anëtari i tretë nga MASHT-i pa e specifikuar emrin, i kemi kërkuar ministrisë që te na dërgoj anëtarin nga MASHT-i mirëpo nuk kanë staf të mjaftueshëm me e dedikuar për komuna varësisht kush është i lirë ky është ndryshimi prej asaj që e keni votuar, ju kërkoj që ta votoni që ta përcjellim tutje. Në bazë të udhëzimit administrativ 151/2020 neni 6 pika 9 thotë që komisioni nga DKA caktohet për 1 vit, dhe mandati për komisioni përzgjedhës për drejtor dhe zvdrejtor është për një vit.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë te rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, në mënyre anonime kaloj.
Për votuan 16 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6 Propozim vendim për shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2 të vendimit Nr. 12-360/02-9351 i datës 26.02.2021**

Drejtori i Shendetesisë Arsim Haxhiu, ky propozim vendim ka të bëjë me shfuqizimin e pikës 2.4 të nenit 2 të vendimit Nr. 12-360/02-9351 i datës 26.02.2021, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të banesës nr 1 përdhese/A blloku dytë Drenasi III. Propozim vendimi ka për qëllim tua ve ne dispozicion komisioni neper çështje të banimit social të kuvendit për procedura dhe hapa me tutje për çështje të banimit të përkohshëm social.

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hodhi në votim këtë pikë te rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, në mënyre anonime kaloj.
Për votuan 16 anëtar, kundër 00, abstenim 00.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për lirim nga pagesa e peronizmit për kompanitë e transportit publik të udhëtareve me autobus për linjat urbano-peiferike dhe nder urbane që e shfrytëzojnë Stacionin e Autobusëve për operim.**

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, meqë nuk pati diskutime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, në mënyre anonime kaloi kjo pikë e rendit të ditës.

Për votuan 16 anëtar, kundër 00, abstenim 00

Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Të ndryshme**

Sabrije Kukaj, kur po fillojnë procedurat shporonim i pronave rreth shtratit të lumit dhe rregullimi i shtatit të lumit, e di që ministria e ka këtë pjesë mirëpo edhe komuna duhet me ndërmarre diçka.

Vehbi Berisha, pyeti a i takon a nuk i takon subvencionimin për vërshime për biznese?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, niveli qendror kur të vendos sepse nuk ka vendos ende, ne ia kemi dërguar raportin dhe ky është projekt i nivelit qendror. Unë e kam paditë ministrinë për punën që nuk e ka përfunduar e ka pas për obligim pjesën e parë, dhe ju e dini që gjitha demet e vërshimeve i kemi pas pse nuk ka qenë lumi i rregulluar, ne nuk kemi me e shpronësu sepse nuk kemi as buxhet, dhe tani ligji ka ndërruar asnjë projekt nuk bëhet pa e bërë shpronësimin, këtë rast qeveria e benë shpronësimin qeveria e ndërton lumin sepse demet i ka të riparueshme.

Mbledhja përfundoi rreth orës **11:56 min.**

Procesmbajtëse:

Liridona Fejza-Ajazi

Fakete Hoti


Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
ZYRA E KRYETARIT



Nr. 01-360/01-25563 dt. 11.06.2021

Në vështrim të nenit 14.2 dhe 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1.neni 4 pika 1.1.neni 7 pika 1, neni 12 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, dhe Vendimit Nr. 12-020-11267 të datës 27.02.2019 të Komisionit për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social, Rekomandimit Nr.01-052-25537, të dt. 11.06.2021 të këtij komisioni, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e pikës 17 të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019 të Kuvendit Komunal të Drenasit

Neni 1

1. Shfuqizohet pika 17 e nenit 1 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të *Banesës me Nr. 19, Kati III-të*, Blloku I në Drenasin III, z. Agim Xhemajlaj.

Neni 2

Me këtë Propozim -Vendim do të njoftohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, pala, Zyra e Kryetarit dhe një mbetët për evidencë.

Neni 3

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga MAPL-ja.

Kryetari i Komunës
Ramir Lladrovci

Ar sy e t i m

Më Ligjin Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, të dala nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim Social 2019-2021, rregullohet çështja e Banimit të Përkohshëm Social, në mënyrë që tu mundësohet zgjidhja e nevojave të banimit familjeve të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike ta zgjidhin këtë problem. Rrjedhimisht me Vendim Nr. 12-360-68569, dt. 29.11.2019 të K.K. Drenas, janë caktuar shfrytëzuesit e Banimit të Përkohshëm Social në periudhën kohore të caktuar.

Me kërkesën Nr. 06-360/01-22633, të 31.05.2021 të ushtruar nga z.Agim Xhemajlaj është kërkuar që me vetëdëshirë të lirojë Banesën me Nr. 19, Kati III-të, në Bllokun I në Drenasin III, përkatësisht të bëjë dorëzimin e çelësit të kësaj banese, si shfrytëzues i banesës së lartëshënuar për shkak se e ka zgjidhur çështjen e banimit, përkatësisht ka ndërtuar shtëpi në Zabel të Ulët, K. Drenas. Me paraqitjen e kësaj kërkesë Komisioni për verifikim-kontrollimin e familjeve në Bllokun Nr. I dhe II, në Drenasin III, i caktuar me vendim të DSHMS-së, ka bërë pranidorëzimin e çelsave të Banesës me nr. 19, Kati III, në Drenasin III, nga Agim Xhemajlaj si shfrytëzues i përkohshëm i kësaj banese. Duke konstatuar se banesa është e zbrazët dhe në gjendje të mirë është bërë edhe ndërrimi i cilindrit të derës së kësaj banese, me ç'rast është njoftuar Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social (i caktuar me Vendimin nr.12-020-11267 të datës 27.02.2019), për zhvillimin e procedurave të të mëtejme ligjore.

Marrë parasysh gjendjen aktuale Komisioni për Çështje të Banimit të Përkohshëm Social vendosi që të vie me rekomandim, përkatësisht të zhvilloj procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi, në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimeve Administrative, duke propozuar që të bëhet shfuqizimi i pikës 17 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, për lejmin e vazhdimin të kontratave me qira joprofitabile mbi dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të banesave sociale në Bllokun e banimit I dhe II në Drenasin III, përkatësisht pikës 17 të nenit 1 të këtij vendimi.

Ky propozimvendim vie në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për të arritur stabilitet social dhe mirëqenje njerëzore duke hapur mundësi për familje tjera në nevojë si qellim themelor i Programit të Banimit të përkohshëm Social.

REPubLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

Pranuar		11.06	2021
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400/01-25650		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
KOMUNA DRENAS (GLLOGOC)
Zyra e Kryetarit



DRAFT - KORNIZA
AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
2022 - 2024

Drenas, qershor 2021

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. STRATEGJIA ZHVILLIMORE KOMUNALE - DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME

III. KORNIZA FISKALE

- 3.1 Korniza makroekonomike komunale
- 3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2022-2024
- 3.3 Plani Komunal i Bashkëfinancimit Sektorial me Ministrinë e Linjës dhe Financimi i Jashtëm
- 3.4 Politikat e reja
- 3.5 Shpenzimet komunale dhe parashikimet 2022-2024
- 3.6. Analiza Gjinore

IV. KORNIZA E PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE


V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

I. HYRJE

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB-i), që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor komunal. Gjithashtu, KAB-i, siguron mekanizmat e nevojshëm për t'arritur objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, përmes integritit sa më të mirë në procesin buxhetor.

Kuadri Ligjor: Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2022/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT-ja) në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP-it).

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2022-2024. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB-it Komunal dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



II. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME 2022-2024 NGA STRATEGJIA ZHILLIOMORE KOMUNALE

Komuna e Drenasit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës, në një sipërfaqe prej: 275.63 km², apo 2.66 për qind e sipërfaqës së territorit të Kosovës. Është njëra nga komunat e mesme të vendit. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Drenasit ka gjithsej 42 vend banime. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna ka 58,451 banorë të organizuar në 8,816 ekonomi familjare, ndërsa për vitin 2022 vlerësohet të ketë përafërsisht 63,174 banorë.

Mbi 2000 biznese operojnë brenda territorit të Komunës. Bazuar në të dhënat e Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në Komunën e Drenasit, afërsisht gjysma e tyre merren me veprimtari tregtare, 42% në sektorin e shërbimeve, afërsisht 4.0% në prodhimtari, pjesa tjetër në transport.

Administrata e Komunës së Drenasit është e organizuar përreth zyrave qendrore dhe zyrave lokale që ofrojnë shërbime në nivel të komunitetit. Nga të cilat pesë (5) janë të vendosura në fshatra .

Vizioni i mëposhtëm për Komunën i definuar pas konsultimeve me akterët e rëndësishëm të jetës politike ekonomike e sociale në Komunë bazohet edhe në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, që ka zhvilluar komuna siç janë: në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-i) 2022-2024 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve në bazë të saj, si dhe Qarkoret Buxhetore

Komunale 2022 (I)+(II), të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Për tri vitet e ardhshme, vizioni i Komunës së Drenasit është të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të zhvilluara dhe ofrim të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmbushjes së këtyre dy attributeve binjake prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër (4) prioritete që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Katër nga këto prioritete kanë të bëjnë me realizimin e objektivave jashtë, ndërsa një prej tyre është i brendshëm dhe kontribuon në zhvillimin e shërbimeve më të mira komunale për qytetarët e Komunës së Drenasit:

1. FORCIMI I EKONOMISË KOMUNALE ME MUNDËSI PËR TË GJITHË

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për studime, laboratore)
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor dhe blegtorisë

2. PËRMIRËSIMI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SË QYTETARËVE

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile
- Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive

3. PËRMIRËSIMI I AMBIENTIT TË KOMUNËS DHE QËNDRUESHMËRIA E TIJ

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit
- Përmirësimi të standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i Komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. KRIJIMI I QEVERISË KOMUNALE QË OFRON SHËRBIME EFIKASE DHE QË U PËRGJIGJET KËRKESAVE TË QYTETARËVE

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes:

- ◆ Ndërtimit dhe rekonstruimit të zyreve komunale (të gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve.

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2022-2024 do të shoqërohen me një miks të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë kryesore ekonomike të shpenzimeve të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve. Alokimi i shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave, si dhe arritje e vlerës më të madhe për fondet e shpenzuara.

III. KORNIZA FISKALE KOMUNALE

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtëpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e Qeverisë Qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2022-2024 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, Konsumi dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2022 - 2024 parashihet një rritje reale vjetore mesatarisht, viti 2022 prej 4.5% derisa në vitet 2023-2024 prej 4.0% deri 4.1% , vlerësime në mesin e institucioneve (MFPT, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore dhe FMN-ja).

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme pritet të zbutet, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë: **1. Të Hyrat Vetanake dhe 2. Grantet Operative.** Komunitat po ashtu janë pranuese të **granteve të donatorëve** (me mbulim të plotë apo si pjesë të bashkëfinancimeve) si dhe kanë mundësinë e huamarrjes sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Komuna e Drenasit në periudhën afatmesme buxhetore 2022-2024 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik

Përshkrimi	2021 (vitin e 1)	2022 (vitin e 2)	2023 (vitin e 3)	2024 (vlerësim)
Indikatorët kryesorë ekonomikë, nivel vendi				
Rritja reale e BPV, në mesin e institucioneve	-3.2%	4.5%	4.0%	4.1%
Konsumi	1.4%	2.1%	1.5%	2.7%
Investimet	13.5%	9.1%	8.9%	7.1%
Eksporti	18.2%	10.4%	8.5%	6.4%
Importi	7.1%	4.9%	4.1%	4.4%
IÇK	1.9%	1.2%	1.0%	1.0%
Deflatori	1.4%	1.3%	0.9%	1.2%
Çmimet e Importit	2.5%	1.6%	1.2%	0.0%
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	62,753	63,174	63,932	64,325
Numri i bizneseve aktive	1,828	2,038	2,245	2,399
Numri i nxënësve	12,194	11,897	11,690	11,450

Burimi i të dhënave: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve- Qeveria e Kosovës, 2022-2024 dhe drejtoratet komunale.

3.2. TË HYRAT KOMUNALE DHE PARASHIKIMI AFAT-MESËM 2022-2024


Të hyrat e Komunës së Drenasit nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje nga viti në vit.

Tabela 2: Buxheti total i komunës në vite , shprehur në Euro:

Të hyrat sipas sektorve	Aktuali	Projeksioni		
	2021	2022	2023	2024
Sektori i Administratës	6,842,148	7,082,707	7,418,954	7,773,074
Sektori i Arsimit	6,472,572	6,678,770	7,012,458	7,362,781
Sektori i Shëndetësisë	2,084,614	2,084,614	2,189,245	2,299,007
Gjithsej të hyrat:	15,399,334	15,846,091	16,620,657	17,434,862

Në bazë të planifikimit të bërë në vitin 2022, të hyrat buxhetore për Komunën si tërësi do të shënojnë rritje graduale. Rritja e të hyrave buxhetore për vitin 2022 do të jetë mesatarisht 2.90% në krahasim

me vitin 2021, sipas projeksionit provues (2023-2024) rritja planifikohet të jetë 10.57%. Brenda kornizës buxhetore (2022-2024) rritja e të hyrave planifikohet mesatarisht 4.89%. Sipas të dhënave të prezantuara në tabelë, rritja e të hyrave në vitin 2022, kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme që planifikohet në nivel të Qeverisë nacionale, siç parashihet me KASH-in 2022-2024. Rritja kryesisht është reflektuar në Grantin e Përgjithshëm dhe të Arsimit (Granti Specifik).



■ Të hyrat sipas sektorve ■ Sektori i Administratës
 ■ Sektori i Arsimit ■ Sektori i Shëndetësisë ■ Gjithsej të hyrat:

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, kanë shënuar rënje të lehtë nga viti në vit po ashtu (vlerësim ky nga niveli qendror). Kjo rënje kryesisht është koncentruar në të hyrat jo tatimore, ndërsa ato tatimore planifikohet të kenë rritje.

KALKULIMET E TATIMIT NË PRONË:

- *Vlera e patundshmërisë* – sipas ndarjes së pronave në kategori të zonave
- *Vlera e kalkuluar vjetore*- që duhet të mblidhet sipas vlerësimit të pronës (nëse supozojmë 100% pagesë sipas normave të përcaktuara me ligj)
- *Norma e pagesës vjetore*- Pagesat për vit, duke përjashtuar pagesat e borxhit, interesin dhe penaltitë, si përqindje e vlerës vjetore të kalkuluar
- *Borxhi i akumuluar dhe pagesa e pritur e borxhit*
- *Ndryshimet e pritura në normën e pagesës vjetore*

KALKULIMET E TË HYRAVE TJERA:

- Të gjitha të hyrat tjera vetanake të komunës janë të hyra jo-tatimore (kryesisht taksa dhe ngarkesa tjera)
- Niveli i taksave dhe pagesave tjera vendoset nën principin e mbulueshmërisë së shpenzimeve të dedikuara për ofrimin e shërbimit komunal.
- Parashikimi i këtyre të hyrave duhet të bëhet duke parashikuar volumin e shërbimeve të ofruara

Tabela 3: Planifikimi i të hyrave buxhetore komunale sipas burimit të financimit dhe kategorive të të hyrave për periudhën 2022-2024, shprehur në Euro (€)

	Komuna: Drenas (Glllogoc)	Grantet dhe THV – 2021	Grantet dhe THV – 2022	Grantet dhe THV – 2023	Grantet dhe THV - 2024
	BURIMET E TË HYRAVE	(këtë vit)	(vitin e 1)	(vitin e 2)	(vitin e 3)
0	GJITHSEJ GRANTET (Fondi10)	14,092,674	14,636,105	15,335,051	16,091,181
	Granti i Përgjithshëm	5,592,488	5,929,721	6,193,348	6,492,393
	Granti Specifik i Arsimit	6,447,572	6,653,770	6,986,458	7,335,781
	Granti Specifik i Shëndetësisë	2,052,614	2,052,614	2,155,245	2,263,007
1	Taksa për shfrytëzimin e të mirave publike (shfrytëzimi i infrastrukturës që komuna ofron)	130,000	141,000	142,000	116,000
	Funksionimet e subjekteve ekonomike brenda teritorit të komunës.	130,000	141,000	142,000	116,000
2	Shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit	95,000	43,000	45,000	47,000
	Lejet për ndërtim dhe konstruktione	95,000	43,000	45,000	47,000
3	Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	85,000	80,000	50,000	50,000
	Përgatitja e plan.urban.dhe inspekt.që kanë të bëjë me dimensionet e pronës	40,000	40,000	25,000	25,000
	Aktivitetet në teren që kanë të bëjnë me matjen e vendit	45,000	40,000	4245,000	25,000
4	Shërbimet e inspektimit të shëndetit dhe sigurisë	24,000	20,000	25,000	30,000
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik	12,000	12,000	14,000	15,000
	Inspektimi i ambientit	4,000	3,000	4,000	5,000
	Inspektimi i ndërtimit,shërbimit të zjarrëfikësve dhe konstruktimit	8,000	5,000	7,000	10,000
5	Shfrytëzimi i pronës komunale	101,000	90,000	42,606	27,681
	Baza ditore apo bazat tjera për shfrytëzimin e pronës publike për aktivitetet komerciale apo jo komerciale	101,000	90,000	42,606	27,681
6	Pagesat në lidhje me automjetet	99,000	99,000	100,000	101,000
	Parkimi në parkingun publik i pajisur me garazhim apo hapësira tjera	9,000	9,000	9,000	9,000
	Regjistrimi i automjeteve	90,000	90,000	91,000	92,000
7	Certifikatat dhe dok. zyrtare	82,000	59,000	60,000	61,000
	Dokum.lidhur me statusin shoqëror si dhe të	80,000	55,000	55,000	55,000

	lindjes, vdekj, martesës, shkurorizimit				
	Të tjera, shërbime	2,000	4,000	5,000	6,000
8	Tatimi në Pronë (objekte & tokë)	495,709	610,000	751,000	836,000
	Pagesat për objekte	386,709	477,000	587,000	684,000
	Pagesat për tokë	109,000	133,000	164,000	152,000
9	Të Hyrat tjera	137,951	10,986	10,000	12,000
	Pagesat tjera	137,951	10,986	10,000	12,000
I-A.	Nëntotali I-A , Të Hyrat direkte (tatimore dhe jo tatimore) (21)	1,249,660	1,152,986	1,225,606	1,280,681
	Denimet në komunikacion, të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK)	N/A	N/A	N/A	N/A
	Gjoha të gjykatave	N/A	N/A	N/A	N/A
I-B.	Nëntotali I-B , Të Hyrat indirekte (Pjesa që i takon komunave)	N/A	N/A	N/A	N/A
I	Totali i Administratës Komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	1,249,660	1,152,986	1,225,606	1,280,681
	TË HYRAT NGA ARSIMI	25,000	25,000	26,000	27,000
	Qerdhet- (bashk-pagesat)	25,000	25,000	26,000	27,000
II	Totali – Arsimi	25,000	25,000	26,000	27,000
	TË HYURAT NGA SHËNDETËSIA	32,000	32,000	34,000	36,000
	1 Shëndetësia –(participimi)	32,000	32,000	34,000	36,000
III.	Totali - Shëndetësia	32,000	32,000	34,000	36,000
Ko	TOTALI I TË HYRAVE	1,306,660	1,209,986	1,285,606	1,343,681
di	VETANAKE TË KOMUNË S (
21	I+II+III) Fondi 21:				
	TOTALI I TË HYRAVE KOMUNALE (10+21)	15,399,334	15,846,091	16,620,657	17,434,862

Komuna vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme (2022-2024) do të përbëjnë afërsisht **92.31%** të buxhetit total të komunës, edhe pse në vitet paraprake pjesëmarrja e granteve në buxhet ka qenë përafërsisht **92%**. Të Hyrat Vetanake mesatarisht planifikohet të marrin pjesë në buxhet me **7.69%**, prej tyre të hyrat tatimore me **57.22%**; ndërsa ato jo tatimore marrin pjesë më **42.78%**. Vlen të ceket se kufijtë e të hyrave sipas burimeve të financimit të buxhetit komunal janë caktuar me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2022-2024, lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Prill/2021. Planifikimi i buxhetit komunal ndërviti pritet të ketë një rritje mesatare prej **4.89%**.

3.2.1. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët

Vlera totale e projekteve më bashkëfinancim me Ministritë e Linjës dhe Donatorët tjerë për vitet 2022-2024 është në shumë prej: 3,112,500 Euro. Nga kjo, vlera investuese për projekte do të ketë rritje prej: 2,408,750 Euro, mjete këto që do të sigurohën nga palët e treta .

Tabela 4: Plani komunal i bashkëfinancimit sektorjal me ministrinë e linjës dhe donatorët.

Emri i projektit	Partneri bashkëfinansues	Gjithsej euro:		Prokurim i nga:	Komente	Opsionale	
		Komuna	Bashkëfinansuesi			% përfitues meshkuj	% përfitues femra
Ndërtimi i Stadionit (Faza e dytë)	MKRS	100,000	900,000	Komuna		50.5	49.5
Total financimi		100,000	900,000			50.5	49.5

3.2.2. Politikat e reja

Komuna e Drenasit në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Fillimisht, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2022-2024, sygjerimet e Qeverisë së Kosovës janë që shuma e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë për qind (10.00%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë Qendrore, (duke përfshirë të hyrat nga shitja e asetëve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2022 dhe 2024 në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Drenasit kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference-negative që do të shkaktohet ulja e nivelit të Grantit të Përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën afatmesme Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shtetërore të ndarjes së Grantit të Arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë Grantin e Arsimit, duhet pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal. **Komuna nuk ka informatat e nevojshme për të bërë analizën e impaktit të kësaj politike.**

Së treti, Komuna ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e komunës. Tutje, komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmën ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike. Në këtë fazë Komunës i mungojnë të dhënat lidhur me kufirin në paga, në mungesë të akteve nën-ligjore për përcaktimin e koeficienteve.

Së katërti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunë, është edhe politika që do të zgjedhet nga viti 2022 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Drenasit aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin e kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërim nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politikave për sigurimin e grantit specifik për këtë fushë.

Së pesti, Komuna ka mirëpritur deklaratimet e Qeverisë Qendrore, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të Hyrat Vetanake Komunale.

Ndërsa sa i përket të hyrave të tjera të Komunës, apo të hyrave vetanake, sërish qeveria nacionale ka shtyrë drejt politikave të reja që do të orientonin komunën drejt avancimit të tatimeve me potencial të mirë dhe zbehjes eventualisht **eliminimit të atyre taksave e ngarkesa komunale** që rëndojnë ambientin biznesor komunal, janë jo transparente dhe fer, karshi qytetarëve respektivisht tatimpaguesit komunal.

Tutje, Komuna e Drenasit, është ballafaquar gjatë dy viteve të fundit me rënien e dukshme të të hyrave nga ngarkesa e bizneseve si rezultat i lirimit të bizneseve nga ky obligim që po e bëjnë disa komuna të Kosovës. **Qeveria Komunale në 3 vitet e ardhëshme planifikon të analizojë trendin e të hyrave nga kjo fushë**, rrjedhimisht në bazë të analizës të propozojë modifikim të vendimit të Asamblesë Komunale, eventualisht propozim të masave shtesë drejt evitimit të çështjeve të dala drejt administrimit të këtij vendimi të marrë nga Asambleja Komunale.

3.3.SHPENZIMET KOMUNALE DHE PARASHIKIMI I TYRE AFAT-MESËM 2022-2024

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuar përmes Qarkores Buxhetore MFT. 2022/01, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2022, duke përfshirë kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Drenasit prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive ekonomike të shpenzimeve buxhetore:

Tabelat e kërkesave fillestare buxhetore (2022-2024) sipas programeve-nënprogrameve buxhetore dhe kategorive kryesore ekonomike të shpenzimeve, shprehur në Euro –(€):

Tabela 5: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2022

Programet:	Paga dhe Mëdit.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Komunale	Subvencione	Sh.Kapitale	Gjithsej:
Z.Kryetarit	157,741	48,985		7,000		213,726
D.Administratës	236,230	131,700			30,000	397,930
D.Inspeksionit	72,691	40,215				112,906
Z.Kuvendit	110,012	46,950				156,963
D.Buxhet-Financa	104,384	18,000				122,384
D.Sh.Publike	174,230	259,049	145,008	90,000	247,600	919,887
D.Infrastrukturës	48,040	25,879			2,733,246	2,807,166
Z.Kom.Kthim	8,023	530				8,553
D.Bujqësi, Pyltari	73,583	12,327		50,000		135,910
D.Zhv.Ekono.	49,033	11,078		23,000		494,935
D.Gj,K,Pronë	83,857	18,417			400,000	107,038
D.Urbanizem	48,621	23,600			40,000	95,633
Adm.Shëndetësi	37,021	89,949		25,000		151,970

QKMF-ja	1,306,644	405,114	50,000		322,856	2,084,614
QPS-ja	92,841	16,713	6,000			115,554
D.K,R,Sport	76,700	16,713		95,000	245,000	115,554
Adm.Arsim	76,593	317,147	6500	80,000	402,000	875,740
Ars.Para-Fillor	119208	46,482	65,000			172,190
Ars.Fillor	4,571,114	373,398	22,000			5,009,512
Ars.Mesem	1,296,934	75,507				1,394,441
R.përmbledhës	8,743,500	2,013,380	298,508	370,000	4,420,702	15,846,091

Tabela 6: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2023


Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.K omunale	Subvenci one	Sh.Kapital e	Gjithsej:
Z.Kryetarit	158,530	48,985		8,000		215,515
D.Administratës	237,411	130,700			10,000	378,111
D.Inspeksionit	73,054	39,515				112,569
Z.Kuvendit	110,562	45,450				156,012
D.Buxhet-Financa	104,906	18,500				123,406
D.Sh.Publike	175,101	267,254	130,925	90,000	248,523	911,803
D.Infrastrukturës	48,280	26,008			3,502,373	3,576,661
Z.Kom.Komun.	8,063	540				8,603
D.Bujqësi,Pylltari	73,951	12,329		55,000		141,280
D.Zhv.Ekonomik	49,278	11,078		25,000		494,935
D.Gj,K,Pronë,	84,276	18,417			400,000	107,281
D.Urbanizem	48,864	27,100			40,000	101,378
Adm.Shëndetësi	37,206	53,340		30,000		120,546
QKMF-ja	1,313,177	462,502	73,905		339,661	2,189,245
QPS-ja	93,305	16,713	5,952			115,970
D.K,R,Sport	77,084	89,949		112,000	172,000	451,033
Adm.Arsim	76,976	300,000		80,000	408,995	865,971
Ars.Para-Fillor	119,804	45,000	6,120			170,924
Ars.Fillor	4,593,970	300,000	87,217			4,981,606
Ars.Mesem	1,303,419	75,000	19,389			1,397,808
R.përmbledhës	8,787,218	1,988,380	323,508	400,000	5,121,552	16,620,657

Tabela 7: Kërkesat fillestare buxhetore për vitin 2024

Programet:	Paga dhe Mëd.	Mall dhe Shërbime	Shërb.Ko munale	Subvenci one	Sh.Kapital e	Gjithsej:
Z.Kryetarit	159,323	46,985		8,000		214,308
D.Administratës	238,598	130,700			5,000	374,298
D.Inspeksionit	73,419	42,415				115,834
Z.Kuvendit	111,115	14,950				126,065

D.Buxhet-Finan.	105,431	18,500				123,931
D.Sh.Publike	175,977	245,231	126,572	90,000	249,451	887,231
D.Infrastrukturë	48,521	26,138			4,208,524	4,283,183
Z.Kom.Komun.	8,103	670				8,773
D.Bujqësi,Pyllta	74,321	13,200		60,000		147,521
D.Zhv.Ekon.	49,524	11,078		27,000		495,354
D.Gj,K,Pronë	84,697	18,417			400,000	107,525
D.Urbanizem	49,108	29,800			40,000	106,325
Adm.Shëndetësi	37,392	53,340		35,000		125,732
QKMF-ja	1,319,743	462,502	81,029		435,733	2,299,007
QPS-ja	93,772	16,713	7,447			117,932
D.K,R,Sport	77,469	89,949		70,000	167,000	404,418
Adm.Arsim	77,361	317,163		80,000	416,112	890,636
Ars.Paraf-Qer.	120,403	48,482	6,120			175,005
Ars.Fillor	4,616,940	326,640	82,340			5,026,340
Ars.Mesem	1,309,936	75,507	20,000			1,405,443
R.përmbledhës	8,831,144	1,988,380	323,508	370,000	5,921,820	17,434,852

Tabelat e lartshenuara, paraqesin planifikimin e shpenzimeve sipas karakterit ekonomik dhe funksional për vitet 2022-2024, **bazuar në kërkesat fillestare** të mbajtësve të buxheteve komunale (drejtoratet dhe zyrët komunale). Vlerësimet e përgjithshme për kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve janë si më poshtë:



3.3.1 Pagat dhe Mëditjet – Qarkorja buxhetore 2022/01-MFPT., përfshinë të gjitha kategoritë e shpenzimeve, e po ashtu Pagat dhe shtesat. Punësimi: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik, përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti. Pagat dhe shtesat: Programet buxhetore duhet të planifikojnë rritjen vjetore të faturës së pagës në nivel prej 0.5% sipas nenit 22C, pika 1.4 të Ligjit 05/L-063. **Kërkesat e programeve buxhetore për paga dhe mëditje të paraqitura në tabelat e lartë shenuara janë**

fillestare, të cilat në fazat e më vonshme të planifikimit të buxhetit do të vlerësohen dhe miratohën sipas Qarkores Buxhetore 2022/02-MFPT.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet.- do të mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Programet buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit qendror dhe lokal, për përmbushjen e aktiviteteve me prioritet të lartë. Mjetet e planifikuara duhet të shpërndahen në menyre objektive nëpërmënkategoritë e mallrave dhe shërbimeve dhe dotë mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme.

3.3.3 Shpenzimet e Shërbimeve Komunale.- priten të ketë pjesëmarrje të njëjtë krahasuar me vitin 2021.

3.3.4 Subvencionet dhe transferet: kjo kategori ekonomike e shpenzimeve pritet të rritet mesatarisht për 1.74% në periudhën afatmesme. Kërkesat fillestar buxhetore të mbajtësve të buxheteve, duke u bazuar në projekte konkrete, do të financohen varësisht nga kufiri i caktuar me Q.B/02-MFPT.

3.3.5 Investimet Kapitale - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 31.05% të shpenzimeve totale në periudhën afatmesme. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritare që përmban projekte me ndikim të përmirësimit të jetës së qytetarve. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshem planifikohet të bashkëfinancohenë me ministrit e linjës dhe donatorët.

3.4 Analiza Gjinore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, si në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8:

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011	%	Gjithsej popullsia e vlerësuar për vitin 2022 (31 dhjetor 2022)	%
Gra	13,516	23.12	14.615	23.13
Burra	13,956	23.88	15.077	23.86
Vajza	15,242	26.01	16.470	26.07
Djem	15,737	26.99	17.012	26.92
Popullata e përgjithshme	58,451	100.00	63.174	100.00

Meqenëse deri më tani është punuar në projekte kapitale të infrastrukturës, ndarja buxhetore nuk ka mund të bëhet sipas barazisë gjinore. Komuna në të ardhmen do të mundohët që të bëjë planifikimin e investimeve kapitale në proporcion të barazisë gjinore. Me zvoglimin e numrit të projekteve në infrastrukturë, do të mbesin mjete për projekte tjera dhe do të merret parasysh më përseafirmi barazimi gjinor gjatë shqyrtimit të projekteve të ndryshme. Komuna tani për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor ka një analizë, e cila do të shërbejë si bazë për ndarjen buxhetore sipas barazisë gjinor. Më te synohet që të përvetësohet një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burrave.

V. INFORMACIONET SIPAS PROGRAMEVE

ZYRA E KRYETARIT

Misioni: Bënë mbikqyerjën e përgjithshme të administrimit financiar të komunës, kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i Komunës, përfaqëson Komunën, në pajtim me kryesuesin e Kuvendit konvokon mbledhjet e Kuvendit të Komunës, kujdeset për zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe Statutit të Komunës, si dhe bënë propozime për qeshtje të caktuara që janë në interes të përgjithshëm të Komunës.

Vizioni: Avansimi dhe perfeksionimi i menaxhimit në pajtim me të gjitha normat ligjore. Arritja e pajtueshmërisë së plotë me të gjitha normat ligjore, ruajtja dhe shtimi i vlerës së pasurive që posedon Komuna. Shfrytëzimi i mjeteve buxhetore me një nikoqirllak dhe duke u bazuar në parimin vlera për parat. Avansimi i vazhdueshëm profesional i të gjitha burimeve humane.

Qëllimi: Ngritja e zhvillimit ekonomik, ngritja e mirëqenjes sociale dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, punë dhe zhvillim. Orimi sa më i mirë i të gjitha shërbimeve për qytetarët e Komunës. Shendrrimi i administratës në një administratë moderne, sa më funksionale dhe të rregullt. Shfrytëzimi sa më racional edhe ekonomik i të gjitha burimeve njerzore, financiare dhe materjale që ka Komuna në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	19	19	19
2	Numri i shërbimeve			
	Konvokimi i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në bashkëpunim me kryesuesin	12	12	12
	Pjesëmarrja në mbledhjet e Komitetit për politikë dhe financa dhe komitetet tjera	20	20	20
	Përfaqësimi i Komunës brenda dhe Jashtë vendi Organizimi i mbledhjeve me publikun dhe perfaqësuesit e komuniteteve	15	15	15
	Kryerja e auditimeve të rregullta	8	8	8
	Raportimet para Komitetit të Auditimit	6	6	5
	Raportimet para Njesisë Qendrore Harmonizuese	4	4	4
	Bashkëpunimi me ZAP-in	2	2	2
	Bashkëpunimi me mediat e shkruera dhe elektronike	365	365	365
	Redaktimi i faqës zyrtare të informimit të Komunës	200	200	200
	Regrutimet e punonjësve të rinjë	5	5	5
	Trajnimi i punonjësve	70	70	70
	Avansimi i punonjësve	10	10	10
	Raportimi për rrjedhën e detyrave në lidhje me PVPE	30	30	30
	Përfaqësimi i Komunës në Kontestet gjyqësore	35	33	30
	Gjithësej: kuantitativ	782	792	788

Për realizimin e punëve të planifikuara me lartë më afat, kualitet duhet të sigurohën mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

ZYRA E KUVENDIT

Misioni: Zbatueshmëria e ligjeve në fuqi, përgatitja e akteve normative në përputhshmeri me ligjin si dhe arhivimin e të gjitha këtyre akteve.

Vizioni: Planifikimi i punëve sipas ligjeve në fuqi dhe akteve tjera nënligjore dhe realizimi i këtyre punëve sipas planifikimit.

Qëllimi: Përgatitja e materialit për kuvend, mbajtja e procesverbalve dhe nxjerrja e vendimeve të aprovuara nga kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve për MAPL-al.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	-	-	-
2	Numri i shërbimeve			
	Punët kuantitative në nr. Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit	12	12	12
	Mbajtja e mbledhjeve të rregullta të KPF	14	14	14
	Pranimi i propozim vendimeve nga ekzekutivi dhe dërgimi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend	60	60	60
	Mbajtja e procesverbalëve në mbledhjet e KPF-së dhe Kuvendit	26	26	26
	Përgatitja e vendimeve të dala nga Kuvendi si dhe dërgimi i këtyre akteve Kryetarit të Komunë dhe MAPL	60	60	60
	Takimet e Komitetit për Komunitete dhe atyre konsultative me Komisionet e Kuvendit Komunal	44	44	44
	Gjithësej:	216	216	216

Për realizimin e punëve të planifikuara me lartë më afat, kualitet duhet të sigurohën mjetet financiare sipas kërkesave të programit.

DREJTORATI PËR ADMINISTRAT TË PËRGJITHSHME

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ushtron dhe zbaton shërbime të përgjithshme për organet administrative dhe tjera komunale, si dhe ofron shërbime për qytetarët e Komunës së Drenasit në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore të saj.

Misioni: Ofrimi i shërbimeve cilësore për qytetarët në afat të shkurtër kohor dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punët e Kuvendit të Komunës, të Bordit të Drejtorëve dhe trupave tjerë punues. Të Siguroj shërbime efektive për qytetarët dhe të siguroj transparencën e shërbimit civil komunal.

Vizioni: Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe cilësore për qytetarët, organet administrative dhe organet e tjera komunale. Vizioni dhe qëllimi ynë si drejtorat është të ofrojmë shërbime më të mira komunale, duke ndikuar në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe përmes tyre të rrisim shkallën e knaqëshmerisë së qytetarëve për shërbimet administrative komunale.

Qëllimi: Qëllimet e Drejtorisë së Administratës janë ngritja e performancës komunale, shërbime komunale cilësore për qytetarët dhe organet e saj administrative.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	42	42	42
2	Numri i shërbimeve			
	Ekstrakte certifikatash të gjendjës civile	55000	56000	57000
	Procedura të prokurimit publik	200	225	230
	Vërtetime të ndryshme dhe legalizim dokumentësh	298	305	310
	Gjithësej:	55498	56530	57540

Të gjitha punët e planifikuara sipas viteve 2022-2024 do të kryhën me cilësi, nëse lejohet buxheti i kërkuar më lartë, në të kundërt do të mungojë si cilësia ashtu edhe kuantiteti (sasia).

DREJTORATI PËR INSPEKSION

Misioni: Menaxhimi dhe mbikqyrja e zbatimit të detyrave programore të inspektorve në kuader të drejtoratit, hartimi i planeve ditore dhe javore në zbatimin e programeve të punës në të gjitha lëmit inspektuese.

Vizioni: Sigurimi i të gjitha procedurave, udhëzimeve dhe politikave për inspektimin sa më të mirë të aktiviteteve të këtij Drejtorati.

Qëllimi: Qëllimi kryesor i Drejtoratit të Inspeksionit është mbikqyrja e ndertimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje ndertimi dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje ndertimi, inspektimi lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve ekonomike me certifikata të biznesit, si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, deklaronin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj. Po ashtu qëllimi i këtij drejtorati është mbikqyrja e kualitetit të ushqimit të produkteve të ambalazhuara dhe të pa ambalazhuara, ujit të pijës pastertisë së qytetit, tregjeve, rrugëve, trotuarve si dhe inspektimi i ujërave të zeza etj. Qëllim tjetër është mbikqyrja e kompanive transportuese në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, inspektimet në lëminë e bujqësisë farërat, plehrat, të mbjellat pranverore e vjeshtore etj.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	11	11	11
2	Numri i shërbimeve: Kuantitative			
	kontrollime	2030	2150	2250
	Procesvebale	1250	1380	1830
	Pëlqime	130	150	200
	Gjithësej kuantitative:	3410	3680	4280
3	Numri i shërbimeve: Kualitative			
	Aktvendime	280	300	300
	Fletparaqitja	120	150	180
	Konkluzione	80	100	100
	Konfiskim malli	20	25	30
	Gjithësej kualitative:	500	575	610

Të gjitha punët e planifikuara sipas viteve 2022-2024 do të kryhën me cilësi nëse lejohet buxheti i kërkuar më lartë, në të kundërt do të mungojë si cilësia ashtu edhe kuantiteti (sasia).

DREJTORATI PËR BUXHET DHE FINANCA

Misioni: Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efikase dhe përgjegjësi dhe konformë me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të obligimit dhe detyrave që i ka për të kryer.

Vizioni: Është themeluar në bazë të Statutit të Komunës dhe dispozitave tjera ligjore. Drejtorati për Buxhet dhe Financa është themeluar në mënyrë që ti kryej obligimet në formë efikase dhe përgjegjësi dhe konformë me legjislacionin në fuqi, më qëllim të realizimit të implementimit dhe realizimin e politikave fiskale të hartuar nga Qeveria qendrore dhe implementimin e politikave lokale.

Qëllimi: Drejtorati për Buxhet dhe Financa bënë planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit – financave të komunës i siguron programet- nënprogramet (drejtoratet dhe zyret komunale) me shërbimet e kontabilitetit, duke siguruar raportim ditor, javor , mujor , periodik dhe përfundimtar lidhur më zhvillimin e buxhetit komunal si dhe informon lidhshpërisht komunal me aktualitetet e ndërlydhura me buxhetin- financat e komunës.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	16	16	16
	Numri i shërbimeve			
2	Zhvillimi i aktiviteteve për planifikimin e buxhetit 2021-2023, sipas kërkesave fillestare,	1	1	1
	Përgatitja e Kornizës afatmesme Buxhetore 2021-2023	1	1	1
	Vertetime për pasuri për qytetar lidhur me rregullimin e dokumentacionit	19,956	20,030	20,050
	Aprovimi i pagesave	4,119	4,125	4,130
	Zotime për ekzekutim pagesave	4,119	4,125	4,130
	Shpenzime	4,119	4,125	4,130
	Lëshimi i faturave sipas kërkesave të palve	10,240	10,300	10,350
	Objekte të reja të matura dhe rimatura	724	730	750
	Numri i ankesave dhe kërkesave për korigjim	60	65	70
	Kërkesa për regjistrimin e objekteve të reja	203	210	230
	Anketim i tatimpaguesve	2,550	2,650	2,700
	Modifikim i të dhënave të pronës	27,350	27,400	27,450
	Modifikim i të dhënave të tatimpaguesve	11,119	11,125	11,130
	Verejtjet e fundit	212	220	230
	Raporte të barazimit tre mujor	4	4	4
	Raporte financiare tre mujore	4	4	4
	Raporte pune gjashtmujore	2	2	2
	Raporti vjetor dhe Pasqyrat vjetore financiare	1	1	1
	Pagesa arke peti cash	35,176	35,200	35,250
	Gjithësej:	119,962	120,318	120,613

Për realizimin e punëve të planifikuara më lartë me afat, performancë të lartë dhe të bazuara në ligje dhe dispozita ligjore në fuqi, duhet të sigurohën mjete financiare sipas kërkesave për kategori ekonomike të shpenzimeve.

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Misioni:Raporton rregullisht Kryetarin e Komunës për punën e Zyrës, i dorëzon Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës raport vjetor, paraqetë raport në çdo takim të Komitetit për Komunitete , informon dhe raporton tek institucionet e Qeverisë Qendrore lidhur me aktivitetet e Zyrës, i propozon Kryetarit të Komunës një buxhet vjetor për të siguruar një funksionim të duhur të Zyrës dhe zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve në bazë të kompetencave të veta, merr pjë në mbledhjet e Drejtorve të Komunës, bashkëpunon ngushtë me institucionet e Qeverisë qendrore dhe me organizatat e tjera vendore e ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të Komuniteteve, Kthim dhe Riintegrim.

Vizioni:Të kontribuon drejt zhvillimit të një shoqërie multi-etnike, prosperuese dhe demokratike me të drejta të barabarta.

Qëllimi:Të këshilloj autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	1	1	1
2	Numri i shërbimeve			
	Vizita tek personat e riatdhesuar	350	380	400
	Vizita tek komunitetet pakicë	30	36	40
	Shqyrtimi i kërkesave të tyre	190	180	190
	Mbledhjet me Komitetin për Komunitete	10	10	10
	Mbledhjet me Komisionin Komunal për Riintegrim	12	12	12
	Takimet me Institucionet e Qeverisë së Kosovës	30	28	32
	Takimet me organizata lokale dhe nderkombëtare	20	15	18
	Gjithësej:	641	661	702

Për realizimin e shërbimeve të planifikuara më lartë kërkohet miratimi i buxhetit të planifikuar me kërkesa buxhetore.

DREJTORATI PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Misioni:DBPZHR, është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara me Statutin e Komunës, duka përfshirë: Përgatit dhe zbaton politika të cilat nxisin zhvillimin e Komunës, mundësojnë zhvillimin e bizneseve bujqësore intensive,zhvillimin e bujqësisë përmes përmirësimit të kushteve infrastrukturore, ngritjen e kapaciteteve të fermerëve për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore dhe mbështetjen sektorjale në krijimin e ambienteve të volitshme, përkrahjen e investitorëve vendor dhe të jashtëm për një synim të qëndrueshëm të bujqësisë dhe punësimit.

Vizioni:DBPZHR- është përcaktuar ta forcoj sektorinë e bujqësisë në të gjitha lëmitë e agrobizneseve, të bëjë të mundshëm programet e qëndrueshme bujqësore. Krijimi i një sistemi sektorjal bujqësor intenziv dhe të qëndrueshëm ekonomik.

Qëllimi: DBPZHR-ka për qëllim ta krijoj një sistem sektorjal të bujqësisë intenzive në rritjen e prodhimtarisë dhe të cilësisë për një konkurrencë të denjë në tregun Vendor dhe Rajonal, si dhe mbështetjen e agrobizneseve, fermerëve të vogël, të mesëm dhe të mëdhenjë, përmes granteve dhe subvencioneve, sektorjalizimin dhe zbatimin e kriterëve në dhënien e subvencioneve për fermerët, përkrahjen e zhvillimit të agrobizneseve duke synuar nxitjen e ndërtimit të identitetit dhe brendeve.

Nr.	Numri i të punësuarëve dhe shërbimeve	2022	2023	2024
1	Numri i të punësuarëve	13	13	13
2	Numri i shërbimeve			
	Kërkesat e ndryshme për përkrahje në bujqësi	370	410	450
	Mbështetja e infrastrukturës në projektin e sistemit të ujitjes	200	210	230
	Subvencionimi në Sektorin e Blegtorisë	180	220	250
	Subvencione në Sektorin e Lavertarisë	550	590	610
	Subvencione në Sektorin e Pemëtarisë	180	200	230
	Subvencione në Sektorin e Perimtarisë (Prodhimtarisë Bimore)	140	160	180
	Lëndet për subvencionimin në Grurë, Misër, Perime, Pemë etj.	800	820	850
	Ngritja e kapaciteteve trajnuese në bujqësi	530	580	640
	Krijimi dhe fuqizimi i shoqatave në Sektorin e Biznesit në Buj.	3	5	7
	Mbështetja e Sektorit të BMA-së	30	40	45
	Mbrojtja e Pyjeve, dhe numëri i fletëparaqitjeve	40	35	30
	Trajtimi i Pyjeve me veprime silvikulturore teknike-rallime	20	30	35
	Pyllzimet në sektorin publiko privat	15	20	25
	Krasitja e halorëve të reja të pyllëzuara pas lufte	10	15	20
	Gjithësej:	3068	3335	3602

Për t'i realizuar punët e planifikuara më lartë me suksesë, kërkohët miratimi i buxhetit të kërkuar sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Misioni: Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit është bartëse e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Hartave Zonale dhe Planeve Rregullative Urbane të Hollësishme, bënë implementimin e tyre dhe lëshon lejet e ndërtimit, kujdeset për dokumentacionin investivo-teknik dhe përputhshmërinë e tij me kushtet e dhëna urbano-teknike, lejon shfrytëzimin e hapësirave publike, mbulon sferën e banimit, bashkëpunimin e ngushtë me nivelin qendror përkatësisht Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA).

Vizioni: Komunë me zhvillim të balancuar, planifikim të qëndrueshëm urban, banim mcilësor, mjedis të pastër..

